

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rama ndan pamje nga inaugurimi i Konsullatës së Nderit në Napoli, tregon dhuratën e veçantë
ADRESA	https://kohajone.com/lajme/rama-ndan-pamje-nga-inaugurimi-i-konsullates-se-nderit-ne-napoli-tregon-dhuraten-e-vecante/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 18:40:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 18:36:36 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a74085da4d09774c40fab91550f8759bca992447235d64cc2841f4eca0bd5ee8
TEKSTI	4461baf0840b03a0098766bbbdd4d12dea4ce13638d3678c3327d74df6b9d36a
PAMJA	89512e83ea231ac80deb7fd72790ada32e17c3165de4f5bbd58ea27bf1d518a8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	dab8480a899e6e8ebc0115edfe10ec4d11562ebce06490508e0c1fc2c195a90e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7fc79e204ff2dfa3f9e677f0c9d1bacea0122705418ff355483188747d3235b5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/dab8480a899e6e8ebc0115edfe10ec4d11562ebce06490508e0c1fc2c195a90e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


Rama ndan pamje nga inaugurimi i Konsullatës së Nderit në Napoli, tregon dhuratën e veçantë

LAJME E MARTË, 15 SHTATOR 2026 20:36



Kryeministri Edi Rama ka vijuar vizitën e tij në Napoli, ku mori pjesë në ceremoninë e inaugurimit të Konsullatës së Nderit të Republikës së Shqipërisë dhe zhvilloi një sërë takimesh me përfaqësues të institucioneve akademike italiane. Përmes një albumi fotografik të publikuar në rrjetet sociale, Rama ka ndarë momente nga vizita, mes tyre edhe takimet me rektorë universitetesh dhe përfaqësues të institucioneve që merren me studimet shqiptare.

Një prej ndalesave të tij ishte Katedra e Gjuhës Shqipe pranë Universitetit "L'Orientale" në Napoli, një institucion me një traditë të gjatë në fushën e albanologjisë dhe në studimin e gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare. Gjatë bashkëbisedimit me stafin akademik, Rama u ndal te rëndësia e kësaj tradite, duke propozuar krijimin e një rrjeti më të organizuar që do të mundësonte bashkëpunim më të ngushtë dhe mbështetje më të strukturuar për studimet shqiptare.



"Ta krijojmë një lloj rrjeti këtu në universitet, me idenë që më pas të mund të ndihmojmë në mënyrë më të strukturuar dhe gjithashtu ta përdorim për të ruajtur e për të shfrytëzuar më mirë gjithçka që prodhohet këtu", deklaroi Kryeministri.



Sipas tij, një qasje e tillë do të shërbente jo vetëm për ruajtjen e trashëgimisë së krijuar ndër vite, por edhe për ta bërë më të aksesueshme dhe më të dobishme atë që prodhohet nga kërkimi akademik në fushën e albanologjisë. Gjatë qëndrimit në Napoli, Kryeministri mori gjithashtu një dhuratë simbolike, një statujë të tij në miniaturë.

Vizita u zhvillua në kuadër të forcimit të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Italisë, ndërsa hapja e Konsullatës së Nderit synon të krijojë një pikë të re lidhëse për komunitetin shqiptar dhe për promovimin e interesave shqiptare në zonën e Napolit.

LAJMET KRYESORE



Rama vizitë zyrtare në Amerikë, fjalim në OKB dhe takim me shqiptarët



Nesër pritet vendimi historik, 3 gjyqtarët që kanë në dorë fatin e ish-krerëve të UÇK-së



Vendimi i Gjykatës së Lartë për Veliain, reagon Rama



Zbardhet fatura e misionit shqiptar në Gaza, 4.1 milionë lekë për ushtar



Gjykata e Lartë le në burg Erion Veliain


TË PËRZGJEDHURA



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve



Dëshirat e Spallettit dhe blerjet e Juventus-it



Tesla, drejtimi gjysmë-autonom drejt përshtatjes me rregullat evropiane, thotë Franca



Shpërthen Erion Braçe te Nikoll Lesi në KOHA JONË-DEBAT: Nuk votoj kandidat me "njoftim"!

MË TË LEXUARAT

ETIKETA RAMA

MË SHUMË NGA LAJME



Nesër vendimi për ish-krerët e UÇK-së, deputetja flet nga Haga: Besoj...

108 ditë protestë, Arben Kola thirrje SPAK: Vazhdo me arrestime, çlir...



Shtohet siguria në Hagë, policia largon shqiptarët nga Gjykata Speciale



FOTO/ Protesta e 108-të, pankarta thumbuese ndaj Ramës dhe Ballukut



Presidenti italian Mattarella drejt Tiranës, Alket Hyseni zbulon deta...



Të enjten Kuvend, nga projektligji për pagat e gjyqtarëve tek interpe...

LAJMET E FUNDIT



Rama ndan pamje nga inaugurimi i Konsullatës së Nderit në Napoli, tregon



Nesër vendimi për ish-krerët e UÇK-së, deputetja flet nga Haga: Besoj te triumfi i



Hashim Thaçi nga aktivizmi kundër regjimit serb, roli në UÇK, shpallja e Pavarësisë së Kosovës dhe krijimi i shtetit

